

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli dhe Procesmbajtësen Sanije Troshupa në lëndën penale kundër të pandehurit V. P. për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas akuzës së PTHDP-së në Prishtinë PP.II.nr.3710/15 dt. 04.03.2016 duke vendosur lidhur me Kërkesën e PTH-së në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me dt. 27.01.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHDP-së në Prishtinë PP.II. nr. 3710/15 dt. 04.03.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

V. P., nga i ati E., e lindur më *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në rr. “...” ,me nr. personal *numri personal...* , Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SEPSE

Me datë 18.06.2015, rreth orës 12:39, në Prishtinë, në rreth rrotullim që ndanë rrugët “Tirana, “UÇK” dhe “Ahmet Krasniqi”, deri sa i lartë cekuri ishte duke e drejtuar automjetin e tij të tipit “Audi A4”, me traga të regjistrimit *numri i targave...*, ngjyrë hiri nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 të LSKRR-së , duke mos mbajtur distancën e sigurisë në mes të automjeteve, me të arritur në rr. “Tirana”, me pjesën e pasme automjetin e tipit “Mercedes”, me targa të regjistrimit *numri i targave...*, ngjyrë hiri, të cilin e drejtonte tani i dëmtuari M. B., i cili ishte ndalur para vendkalimit për këmbësor, me ç’rast lëndime të lehta trupore pësojnë të dëmtuarit: M. B., I. B. dhe E. B. si dhe dëm material në veturë,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41.43.46 të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri V. P. dënohet në shumë prej 200 (dyqind euro) €, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88 € dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej 50.00 €,

ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej 20(njëzet) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit M. B. , I. B. dhe E. B. nga F. K. rr. “...” për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore e Prishtinës me akuzën PP.II.nr. 3710/15 dt. 04.03.2016 e ka akuzuar të pandehurin V. P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që ndaj të pandehurit të shqiptohet Urdhri Ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e cekur penale.

Në kuptim të nenit 493 të KPPRK, parashihet se për veprën penale për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose më burgim deri në tre vite, për të cilat prokurori i shtetit është informuar se në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë më aktakuzë që gjykata të jap urdhër ndëshkimor në të cilin do të shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit paraprak të kësaj çështje penale-juridike e duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi i ekspertit mjeko-ligjor V. K., i dt. 05.02.2016, dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit B. G. i dt. 03.09.2015 , foto dokumentacioni si dhe shkresat e lëndës, e aprovoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor ku të pandehurin e shpalli fajtor dhe e gjobiti si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje penalo-juridike në kuptim të nenit 493 të KPPRK-së gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe pranoj Kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit që të paguaj paushallin gjyqësor bazohet me nenin 450 të KPPK-së

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u muarr në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1083/16 me dt. 27.01.2017

Sekretare Juridike
Sanije Troshupa

Gj y q t a r i,
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE: I pandehuri ose mbrojtësi i tij në afat prej 8 ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi-Urdhri Ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.